

VENDIM
Nr. 255, datë 21.12.2021

MBI PROPOZIMIN E SHOQËRISË OST SHA, PËR RREGULLAT E TREGUT SHQIPTAR TË BALANCIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 106, DATË 2.7.2020

Në mbështetje të nenit 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; dhe nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 156/3 prot., datë 17.12.2021, të drejtorive teknike, “Mbi propozimin e shoqërisë OST sh.a. për rregullat e tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr. 106, datë 2.7.2020”,

konstatoi se:

- Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, me vendimin nr. 106, datë 2.7.2020, vendosi miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike.

- ERE me vendimin nr. 89, datë 31.3.2021, mori në shqyrtim propozimin e shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) “Për rregullat e tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike nga data 1 prill 2021”.

- ERE me vendim nr. 155, datë 30.06.2021, mori në shqyrtim propozimin e shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.), për zgjatjen e periudhës kohore, të parashikuar në pikën 3, të vendimit nr. 89, datë 31.3.2021, duke vendosur, ndër të tjera:

1. Pranimin e kërkesës së shoqërisë OST sh.a., për zgjatjen e periudhës kohore të parashikuar në pikën 3, të vendimit të bordit të ERE-s nr. 89, datë 31.3.2021.

2. Deri më 31 dhjetor 2021, periudha kohore e proceseve ku përfshihen edhe nominimet dhe llogaritjet respektive të disbalancave të kryhet me interval kohor prej 1 ore.

- OST sh.a. parashtron se: Në kushtet dhe të shpalljes së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, në zbatim të VKM nr. 584, datë 8.10.2021, OST-ja ka qenë e detyruar të pezullojë investimet e parashikuara për vitin 2021, duke krijuar po ashtu dhe ngadalësim të procesit të implementimit në platformën elektronike DAMAS të specifikimeve që reflektojnë përmbushjen e parashikimeve të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020. Për këto arsye, OST kërkon mirëkuptimin e ERE-s për miratimin e zgjatjes së periudhës së parashikuar në pikën 2, të vendimit të bordit të ERE-s nr. 155, datë 30.6.2021, deri në datën 30 qershor 2022, me qëllim që gjatë kësaj kohe të kryhet harmonizimi i proceseve të Tregut Balancues konform Rregullave të Balancimit, si dhe të proceseve IT në varësi kjo edhe të vijimit të situatës gjatë gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike sipas VKM-së.

- Rritja e çmimeve të energjisë elektrike për furnizim sjell një rritje shumë më të madhe të çmimeve të energjisë elektrike në tregun e energjisë balancuese, ku dhe në kushtet normale çmimet në këtë treg janë më të larta se ato në tregun e realizuar për qëllim tregtimin dhe furnizimin me energji elektrike apo dhe mbulimin e humbjeve në rrjet. Në tregun e energjisë balancuese të vendit tonë janë reflektuar tendencat e rritjes së çmimeve si në tregjet e tjera.

- Përgjatë periudhës së gjashtë mujorit të dytë të vitit 2021 në komunikimet periodike në tregun e balancimit vendas janë hasur problematika me garantimin e energjisë elektrike nga furnizues të caktuar për furnizimin e klientëve respektivë. OST sh.a. nëpërmjet shkresës nr. 5977 prot., datë 8.10.2021, konstaton dhe i bën me dije ERE-s, rritje të devijimeve nga furnizues të caktuar.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 106, datë 2.7.2020, ka miratuar “Rregullat e tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike”, në pikën 4.1.1.4, të këtyre rregullave është përcaktuar se:

- “OST sh.a. është e detyruar të mbajë në balancë sistemin elektroenergjitik duke mos shkaktuar diferenca në rezultatin neto me **qëllim garantimin e neutralitetit të saj financiar** të rregulluar lidhur me shërbimet e balancimit në përputhje me përcaktimet e Metodologjisë së Llogaritjes të Tarifave të Transmetimit të Energjisë Elektrike”.

- Ekspozimi ndaj një risku financiar. mund të çojë në kosto të shtuara për OST sh.a., dhe për rrjedhojë mund të çojë në cenimin e neutralitetit financiar të OST sh.a..

- ERE gjykon se është e nevojshme fillimi i procedurës për rishikimin e pikës 2, të vendimit të ERE-s nr. 89, datë 31.3.2021, “Për rregullat e tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike nga data 1 prill 2021”, në të cilën përcaktohet se: mekanizmi i garancisë financiare që OST sh.a., do të aplikojë për pjesëmarrësit në tregun e balancimit të jetë ai i përcaktuar në Rregullat e Mekanizmit të Përkohshëm të Balancimit, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 193, datë 24.11.2017.

- Sikurse kemi evidentuar më sipër Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 584, datë 8.10.2021, vendosi “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”. Në pikën 3, të këtij vendimi është përcaktuar edhe pezullimi i planeve të investimeve, përveç investimeve jetike për shoqëritë publike përfshi OST sh.a.

- Në këto rrethana parashtrimet e bëra nga OST sh.a., me shkresën nr. 5977/7 prot., datë 9.12.2021, në kushtet dhe të shpalljes së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, ka sjellë ngadalësim të procesit të investimit në implementimin e ndryshimeve në platformën elektronike DAMAS, respektivisht të specifikimeve që reflektojnë përmbushjen e parashikimeve të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020.

- ERE vlerëson të arsyeshme kërkesën e OST sh.a., për zgjatjen e periudhës së parashikuar në pikën 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 155, datë 30.6.2021, deri më datë 30 qershor 2022, me qëllim që gjatë kësaj kohe të kryhet harmonizimi i proceseve të Tregut Balancues konform Rregullave të Balancimit, si dhe të proceseve IT. Ky proces në çdo rast duhet të marrë në konsideratë dhe situatën dhe vijimin e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike sipas vendimeve respektive të Këshillit të Ministrave.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pranimin e pjesshëm të propozimit e shoqërisë OST sh.a., “Për rregullat e tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 106, datë 2.7.2020.

2. Fillimin e procedurës për rishikimin e pikës 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 89, datë 31.3.2021, “Për rregullat e tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike nga data 1 Prill 2021”.

3. Fillimin e procedurës për amendimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020, si më poshtë vijon:

Neni 5.7.6 është:

5.7.6 Garancitë financiare ndryshojnë në varësi të llojit të PPB-së:

5.7.6.1 Për PPB-në - të me njohje tregtare:

a) Madhësia e kolateralit për një PPB përfitohet nga vëllimi në MWh i transaksionit neto më të lartë të asaj PPB me çdo PPB tjetër gjatë një dite kalendarike;

b) Për fillimin e zbatimit të këtyre Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit, madhësia e kolateralit për një PPB përfitohet nga vëllimi i transaksionit neto më i lartë të pritshëm të asaj PPB-je me çdo PPB tjetër gjatë një dite kalendarike, me një minimum prej 50 MWh;

c) Shuma e kolateralit të kërkuar është e barabartë me dyfishin e madhësisë së përmendur në pikën “a”, ose respektivisht “b” e shumëzuar me çmimin mesatar të tregut të energjisë së ditës në avancë, gjatë 3 muajve përpara përcaktimit të kolateralit;

d) Në rast se vëllimi i transaksionit neto më të lartë tejkalon më tepër se shumën në të cilën është bazuar kolaterali, me kërkesën e OST-së, PPB-ja do të rrisë kolateralin e saj, ku kolaterali i ri bazohet në vëllimin e transaksionit neto më të lartë gjatë një dite kalendarike, të vërejtur gjatë 6 javëve paraardhëse pa ndërprerje. Në rast se vëllimi i transaksionit neto më i lartë është thelbësisht më i ulët se shuma mbi të cilën bazohet kolaterali, me kërkesën e PPB-së, OST-ja do të lejojë një shumë kolaterali më të ulët, ku kolaterali i ri bazohet në vëllimin e transaksionit neto më të lartë gjatë një dite kalendarike, vërejtur gjatë 6 javëve paraardhëse pa ndërprerje.

5.7.6.2 Për PPB-në me njohje të plotë

a) Madhësia e kolateralit për një PPB përftohet nga:

i. vëllimi në mwh i transaksionit neto më të lartë të asaj PPB-je me çdo PPB tjetër gjatë një dite kalendarike (për herë të parë bazohet në vlerat e pritshme me një minimum prej 50 mwh);

ii. kapaciteti total i transmetimit në pikat e lidhjes për të cilat ai mban përgjegjësinë e balancimit.

b) Shuma e kolateralit të kërkuar është e barabartë me dyfishin e madhësisë së përmendur në “a”/i, shumëzuar me çmimin mesatar të tregut të energjisë elektrike gjatë 3 muajve para përcaktimit të kolateralit. Kjo është shuma kolaterale A.

c) Kapaciteti i transmetimit siç është përmendur në pikën “a”/ii përcaktohet nga:

i. numri i lidhjeve në nivelin 2–10 mw shumëzuar me kapacitetin më të ulët që shfaqet në atë nivel;

ii. numri i lidhjeve në nivelin 11–25 mw shumëzuar me kapacitetin më të ulët që shfaqet në atë nivel;

iii. numri i lidhjeve në nivelin 26–50 mw shumëzuar me kapacitetin më të ulët që shfaqet në atë nivel;

iv. kapaciteti total i lidhjeve >50 mw, ku përdoren kapacitetet individuale të lidhjes;

d) Kapaciteti total i transmetimit i përcaktuar në këtë mënyrë shumëzohet me 24, ku përfundimi, nëse është më i vogël se 50 mw rritet në 50 mw, pastaj shumëzohet me çmimin mesatar të tregut gjatë tre muajve para përcaktimit të kolateralit. Kjo është shuma kolaterale B.

e) Kolaterali që duhet ti vendosët PPB përcaktohet më poshtë:

i. nëse $(2 * A) > B$, shuma e kolateralit që do t'i vendoset është $2 * A$;

ii. nëse $(2 * A) \leq B$, shuma e kolateralit që do t'i vendoset është $A + B$;

f) Për rregullimin e kërkesave për kolateral, veprohet në të njëjtën mënyrë si me PPB me njohje tregtare (shih paragrafin e mësipërm d) dhe e).

Neni 5.7.6 *Propozohen ndryshimet:*

5.7.6 Garancitë financiare

5.7.6.1 OST-ja ka të drejtën të kërkojë garanci financiare nga palët përgjegjëse për balancim. OST-ja do të shfrytëzojë këtë të drejtë pa diskriminim dhe mbi parimin proporcionalitetit. Niveli i kërkuar i garancisë financiare për çdo palë përgjegjëse për balancim duhet të jetë sa ekspozimi i përgjithshëm neto i faturimeve të muajit paraardhës plus 20%. Ekspozimi mujor financiar për çdo palë përgjegjëse të balancimit llogaritet si diferencë e arkëtimeve dhe pagesave të pritshme të llogaritura. Në çdo rast vlera minimale e garancisë financiare duhet të jetë 10 milionë ALL.

5.7.6.2 Për palët përgjegjëse të balancimit të porsa regjistruara për të cilat nuk ka të dhëna për të llogaritur ekspozimin historik nga disbalancat, OST-ja duhet të aplikojë vlerën fikse për garanci financiare që është 10 milionë ALL.

5.7.6.3 Kur gjatë muajit rezulton se ekspozimi financiar nga disbalancat përbën 70% të vlerës së garancisë:

- OST-ja ka të drejtë të kërkojë menjëherë përditësim e garancisë. Garancia duhet përditësuar brenda 10 ditëve kalendarike nga kërkesa e OST-së drejtuar PPB për përditësim.

- Përgjashtimisht nga parashikimet e nenit 5.8, “Faturimi dhe shlyerja për PPB-në”, në çdo rast, OST-ja do t'i kërkojë PPB-së të paguajë, brenda afatit të përcaktuar nga OST-ja, vlerën e këtij ekspozimi.

4. OST sh.a., të paraqesë në ERE analizën përkatëse për llogaritjen e vlerës minimale të garancisë financiare prej 10 milionë ALL.

5. Zgjatjen e efekteve juridike të pikës 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 155, datë 30.6.2021, deri në datën 15 prill 2022.

6. Përgjatë periudhës së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike sipas VKM-së nr. 584, datë 22.10.2021, OST sh.a. të raportojë çdo javë në ERE mbi ecurinë e tregut të balancimit të energjisë elektrike, duke filluar nga data e publikimit në Fletoren Zyrtare.

7. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët përfshira, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti